



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 13.01.2017

Vendim
Nr. 01, datë 13.01.2017

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR
VITIN AKADEMIK 2017-2018

Mbështetur në nenin 74, pika 2 të Ligjit 80/20 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2017

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2017-2018 si vijon:

a) Fakulteti i Ekonomisë:

- Për programin e studimit të ciklit të parë që ofron Departamenti i Biznesit, kriteret të jenë si vijon:

1. Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.

2. Nota Mesatare e përgjithshme (e ponderuar) të përbëjë 60 % të pikëve totale në vlerësimin e kandidatëve.

3. Nota mesatare e lëndëve të lidhura me profilin (e ponderuar) të përbëjë 30% të pikëve totale në vlerësimin e kandidatëve.

4. Shkolla e mesme që ka përfunduar kandidati në bazë të rankimit të bërë nga MAS të përbëjë 10% të pikëve totale në vlerësimin e kandidatëve.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- Për programin e studimit të ciklit të parë që ofron Departamenti i Financës, kriteret e pranimit të studentëve në këtë cikël të parë të studimit, të jenë:

1. Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për cdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar cdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.

2. Nota Mesatare e përgjithshme (e ponderuar) të përbëjë 60 % të pikëve totale në vlerësimin e kandidatëve.

3. Nota mesatare e lëndëve të lidhura me profilin (e ponderuar) të përbëjë 30% të pikëve totale në vlerësimin e kandidatëve.

4. Shkolla e mesme që ka përfunduar kandidati në bazë të rankimit të bërë nga MAS të përbëjë 10% të pikëve totale në vlerësimin e kandidatëve.

- Për programin e studimit të ciklit të parë që ofron Departamenti i Ekonomiksit, kriteret e pranimit të studentëve në këtë cikël të parë të studimit, të jenë:

1. Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për cdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar cdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.

b) Fakulteti i Shkencave Teknike:

- Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare:

1. Për vitin akademik 2017-2018 pranimi i studentëve në të gjitha programet e ciklit të parë të ofruara nga DIMN, Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Elektrike dhe Inxhinieri Navale, do të bëhet mbi bazën e notës mesatare të shkollës së



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

mesme, pikëve të testit të pranimit (lëndët e profilit teknik dhe shkencor, matematike, fizike, etj) dhe profilit të shkollës.

2. Në llogaritjen e pikëve totale të kandidatëve, nota mesatare e shkollës së mesme do të ketë një peshë prej 30% dhe pikët që do të grumbullohen nga testi do të kenë një peshë prej 70%.

3. Në llogaritjen e pikëve totale të kandidatëve do të merret në konsideratë edhe profili i shkollës së mesme të kryer nga kandidati, duke përdorur koeficientët e mëposhtëm:

- a. Shkollat profesionale teknike (mekanike, elektrike, etj) si dhe gjimnazet e profilit shkencor të kenë koeficientin shumëzues 1.0.
- b. Shkollat e mesme të profilit të përgjithshëm të kenë koeficientin shumëzues 0.9.
- c. Të gjitha shkollat e tjera të mesme të kenë koeficientin shumëzues 0.8.

Në këtë rast pikët e grumbulluara nga testi mbledhen me mesataren e shkollës së mesme e shumëzuar me koeficientin shumëzues të shkollës.

- Departamenti i Shkencave Kompjuterike:

1. Mesatare e ponderuar e shkollës së mesme do të ketë një peshë prej 60% në totalin e vlerësimit.
2. Në llogaritjen e pikëve totale të kandidatëve do të merret në konsideratë edhe lëndët e përzgjedhurane peshën 40%.

TIK 20%,
Matematikë 10%
Fizika 5 %
Gjuha e Huaj 5 %

- Departamenti i Shkencave Detare:

1. Mesatare e ponderuar e shkollës së mesme do të ketë një peshë prej 60% në totalin e vlerësimit.
2. Në llogaritjen e pikëve totale të kandidatëve do të merret në konsideratë edhe lëndët e përzgjedhurane peshën 40%.

Informatikë 15 %
Matematikë 10%



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Anglisht 10 %

Fizikë 5%

- Departamenti i Kimisë:

1. Mesatare e ponderuar e shkollës së mesme do të ketë një peshë prej 60% në totalin e vlerësimit.

2. Në llogaritjen e pikëve totale të kandidatëve do të merret në konsideratë edhe lëndët e përzgjedhura në peshën 40%.

Kimi 15%,

Matematike 10%

Kimi e avancuar 10 %

TIK 5 %

- Departamenti i Matematikës:

1. Mesatare e ponderuar e shkollës së mesme do të ketë një peshë prej 60% në totalin e vlerësimit.

2. Në llogaritjen e pikëve totale të kandidatëve do të merret në konsideratë edhe lëndët e përzgjedhura në peshën 40%.

Matematikë 20%

Matematikë e avancuar 10%

Fizikë 5%

TIK 5 %

- Departamenti i Fizikes:

1. Mesatare e ponderuar e shkollës së mesme do të ketë një peshë prej 60% në totalin e vlerësimit.

2. Në llogaritjen e pikëve totale të kandidatëve do të merret në konsideratë edhe lëndët e përzgjedhura në peshën 40%.

Fizika 15 %

Matematikë 15%

Kimi 5%

Gjuha e Huaj 5 %

- Departamenti i Biologjisë:

Kriteret e pranimi të studentëve të ciklit të parë të studimeve në Departamentin e Biologjisë përbëhn nga 60% nota mesatare e shkollës së mesme për të gjitha



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

vitet, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore (mesatare e thjeshtë) dhe 40% nota mesatare e gruplëndëve (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët, përfshirë dhe notat e maturës shtetërore.

- a) Biologji bërthamë me një peshë 20%
- b) Kimi bërthamë me një peshë 10%
- c) Matematikë bërthamë me një peshë 5%
- d) Fizikë bërthamë me një peshë 5%

c) Fakulteti i Shendetit Publik:

- për programin e studimit “Bachelor në Infermieri Mami” u vendos që:

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Për rastet e studentëve në fund të listës së përzgjedhjes, pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit, për studentët me mesatare të njëjtë, kriter përzgjedhës do të jetë rankimi i institucionit arsimor të bërë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
3. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e lëndëve Biologji dhe Kimi.

- për programin e studimit “Bachelor në Infermieri të Përgjithshme” u vendos që:

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Për rastet e studentëve në fund të listës së përzgjedhjes, pas zbritjes së vijës së fituesit të fundit, për studentët me mesatare të njëjtë, kriter përzgjedhës do të jetë rankimi i institucionit arsimor të bërë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
3. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e lëndëve Biologji dhe Kimi.

d) Fakulteti i Shkencave Humane:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

- Për programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Angleze”, kriteret të jenë si vijon:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 60% të vlerësimit në renditje.
2. Nota mesatare e gruplëndëve të drejtimit shoqëror/human (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët, përfshirë edhe notat e maturës shtetërore) në kurrikulën e shkollës së mesme të ketë 40% të vlerësimit në renditje.
3. Ky grup të përfshijë lëndë të drejtimit shoqëror/human sipas përcaktimeve në përqindje vlerësimi si më poshtë:

Gjuhe e huaj e parë	15%
Gjuhë shqipe dhe letërsi	10%
Qytetari	10%
Histori Arti	5%

- Për programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane”, kriteret të jenë si vijon:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 60% të vlerësimit në renditje.
2. Nota mesatare e gruplëndëve të drejtimit shoqëror/human (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët, përfshirë edhe notat e maturës shtetërore) në kurrikulën e shkollës së mesme të ketë 40% të vlerësimit në renditje.
3. Ky grup të përfshijë lëndë të drejtimit shoqëror/human sipas përcaktimeve në përqindje vlerësimi si më poshtë:

Gjuhe e huaj e parë	15%
Gjuhë shqipe dhe letërsi	10%
Qytetari	10%
Histori Arti	5%

- Për programin “Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”, do të renditen sipas këtyre kriterëve shtesë:

1. Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore do të marrë 60% të vlerësimit në renditje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Nota mesatare e gruplëndëve të drejtimit shoqëror/human (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët, përfshirë edhe notat e maturës shtetërore) në kurrikulën e shkollës së mesme do të marrë 40% të vlerësimit në renditje;
3. Grupi i lëndëve të drejtimit shoqëror/human përmban:

Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	20 %
Gjuhë e huaj	5 %
Histori arti	5 %
Histori	5 %
Qytetari	5 %

- Departamenti i Edukimit propozon:

:

1. Të pranohen studentët në programet e studimit që ofron departamenti duke marrë për bazë 60% të vlerësimit nga mesatarja e përgjithshme e gjimnazit.
2. Të pranohen studentët në programet e studimit që ofron departamenti duke marrë për bazë 40% të vlerësimit të gruplëndëve sipas programeve që ofron departamenti:

Programi "Histori-Gjeografi" lëndët: Histori 15%, Gjeografi 15%, Qytetari 5%, Shkencat e tokës 5%

Programi "Arsim Parashkollor" lëndët: Gjuhe shqipe dhe letërsi 15%, Artet 5%, Matematikë 10%, Histori 5%, Gjeografi 5%,

Programi "Mësues për Ciklin e Ulët" lëndët: Matematikë 10%, Gjuhe shqipe dhe letërsi, 10% Histori 5%, Gjeografi 5%, Qytetari 5%, Biologji 5%,

Programi "Pedagogji e Specializuar Sociale" lëndët: Gjuhe shqipe dhe letërsi 15%, Qytetari 10%, Biologji 5%, Artet 10%.

Në varesi nga gjendja e pranimeve, Departamenti do të marrë vendime mbi kriteret e mundshme të renditjes nga mesatarja më e lartë deri te më e ulëta.

- Për programet "Bachelor" të ofruara nga Departamenti i Drejtësisë:

1. Mesatare e tre viteve të studimeve në ciklin e mesëm bashkë me mesataren e provimeve të matura 60%.
2. Gruplëndët nga kurrikula bërthamë 40 %, të ndara si vijon:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

Gjuhë shqipe dhe letërsi 10 %
Qytetari 10 %
Histori 10 %
Ekonomi 10%.

3. Vendimi protokollohet dhe i percillet MAS-it.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.